



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.6436/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen jokontestimore të propozuesit Sh. M, të cilin e përfaqëson E. A avokat në Prishtinë, ndaj kundërpropozueses Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja nga avokatura shtetërore Naime Abazi nga Prishtina, për shkak të caktimit të lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, duke vendosur sipas ankesës së kundërpropozueses, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan CN.nr.33/20 të datës 17.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e kundërpropozueses Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan CN.nr.33/20 i datës 17.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet propozimi i precizuar i propozuesit Sh. M dhe detyrohet kundërpropozuesi Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Prishtinë-Departamenti i Shpronësimit, që propozuesit t'ia paguaj shpërblimin shtesë respektivisht diferencën për $1/m^2$, shumën prej 6.20€, apo shumën e përgjithshme prej 8,704€, për paluajtshmërinë e shpronësuar, ngastra Kadastrale nr.308-0, me kulturë arë e kl. Të II-të, në sipërfaqe prej $1404m^2$, dhe shumën prej 5,208.50€, për shpërblimin e humbjes së vlerës së pjesës së pa shpronësuar në shkallë 20%, të së njëjtës njësi

Kadastrale me sipërfaqe prej 1834m², me kamatë ligjore prej 7%, nga dita e shpronësimit 27.10.2016, e deri te pagesa definitive si dhe t'ia kompensoj shpenzimet në shumë prej 4,062€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë pala kundërpropozuese, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktvendimi i atakuar, të refuzohet në tërësi si i pa bazuar propozimi i propozuesit, të mbetet në fuqi Vendimi Përfundimtar i Qeverisë së Kosovës Nr.03/30 i datës 20.05.2015 si dhe Raporti i Vlerësimit i datës 05.05.2015.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimi i atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi Sh. M ka parashtruar propozim për caktimin e lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, me të cilën ka kërkuar që të obligohet kundërpropozuesja Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Prishtinë-Departamenti i Shpronësimit, që propozuesit t'ia paguaj shpërblimin shtesë respektivisht diferencën për 1/m², shumë prej 6.20€, apo shumë e përgjithshme prej 8,704€, për paluajtshmerinë e shpronësuar, ngastra Kadastrale nr.308-0, me kulturë arë e kl. Të II-të, në sipërfaqe prej 1404m², dhe shumë prej 5,208.50€, për shpërblimin e humbjes së vlerës së pjesës së pa shpronësuar në shkallë 20%, të së njëjtës njësi Kadastrale me sipërfaqe prej 1834m², me kamatë ligjore prej 7%.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi përfundimtar për shpronësim nr.03/30 të datës 20.05.2015, aktvlerësimin e datës 05.05.2015, aktvendimin e trashëgimisë LRP.nr.2671/15 të datës 02.07.2015 i lëshuar nga Zyra Noteriale F. T, në Lipjan, si dhe ekspertiza e ekspertit F. K e datës 22.11.2016.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: pala kundërpropozuese me vendimin përfundimtar nr.03/30 të datës 20.05.2015, e ka shpronësuar paluajtshmërinë e propozuesit për interes publik me qëllim të ndërtimit të Autostradës R6 Prishtinë-..., dhe atë sipërfaqen prej 1404m² nga ngastra Kadastrale nr.308, me kulturë arë e klasit të II-të që gjendet në ZK ..., dhe pala kundërpropozuese sipas aktvlerësimit për m² të paluajtshmërisë ka vlerësuar në lartësi prej 8€, vlerë kjo për të cilën propozuesi nuk është pajtuar dhe nuk është dakorduar me arsyetimin se pjesa që është shpronësuar ka vlerë më të lartë të tregut dhe që pjesa e mbetur nuk e ka vlerën dhe ka pësuar humbje si rezultat i shpronësimit të kësaj pjese të paluajtshmërisë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktvendim i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të tillë dhe këtë e ka bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaftueshëm i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesës së parashtruar me propozim dhe në lidhshmëri me këtë, ka

arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Nga kjo, kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, sa i përket bazës për kompensim dhe lartësisë së saj, për rastin në shqyrtim, është kryer edhe ekspertimi i nevojshëm. Nga Ekspertiza e grupit të ekspertëve B. S, Sh. A dhe H. R, e datës 08.06.2021, është vërtetuar se ngastra kadastrale nr.308, ka vlerë të tregut prej 14.20€/m², si dhe pjesa e mbetur e pa shpronësuar e ngastrës nr.00308-0 që gjendet në ZK ... ka humbje të vlerës në shkallë prej 20%, apo shprehur në mjete monetare bazuar në çmimin e tregut prej 14.20€, kap shifrën e humbjes së vlerës prej 5,208.00€. Nga një gjendje e tillë e çështjes kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë duke aprovuar propozimin e propozuesit, bazuar edhe në ekspertizën e ekspertëve të lartcekur, të cilët kanë vërtetuar çmimin e ngastrës kadastrale të shpronësuar dhe për sipërfaqen e mbetur pa shpronësuar respektivisht kompensimin në emër të zhvlerësimit në sipërfaqen e mbetur, siç rezulton si në dispozitivin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Lidhur me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me mos vërtetimin e gjendjes faktike, kolegji ka gjetur se, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë dhe masë të plotë dhe në mënyrë të plotë është aplikuar edhe e drejta materiale. Kolegji ka gjetur se mënyra e të vendosurit si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar me ankesë është në përputhje të plotë me nenin 15 të Ligjit për Shpronësimin, në të cilin ligj është përcaktuar në mënyrë të qartë mënyra dhe kriteret e vlerësimit për paluajtshmerinë e shpronësuar.

Kolegji gjen se në nenin 46 par.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar që: *“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet”,* ndërsa në paragrafin 4 të të njetit nen është përcaktuar që: *“Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata*

kompetente". Në nenin 1 të Protokollit shtesë të Konventës Europiane është paraparë që: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

Kolegji pretendimet ankimore të palës kundërpropozuese i ka refuzuar si të pa argumentuara edhe për faktin se pretendimet kundërshtuese ishin të pa bazuara dhe të pa mbështetura në argumente bindëse. Për më tepër pala kundërpropozuese përveç pretendimeve verbale, nuk ka propozuar ndonjë ekspertim shtesë apo ekspertim tjetër që do të argumentonte një gjendje tjetër faktike nga sa është vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Kolegji gjen se në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *"Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër".* Sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret e paditura përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur. Në nenin 319.1 të LPK-së, gjithashtu është vendosur që secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kolegji i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar se, pala kundërpropozuese nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e të njëjtës është refuzuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6436/2021, me datë 08.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi

Dr.sc. Rafet Haxhaj